



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

BASHKIA FIER	
Nr. 6318/7	Prot.
Dt. 12/06/2026	

Sekretari Jeshullat

Nr. 636/1 Prot.

Fier, më 11.06.2026

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr.49, Nr 50 të miratuara në mbledhjen e datës 05.06.2026 të Këshillit të Bashkisë Fier.

BASHKISË FIER ✓

KËSHILLIT TË BASHKISË FIER

Fier

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 6318/6 prot. datë 09.06.2026 protokolluar pranë Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 696 prot. datë 10.06.2026 bazuar në ligjin Nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut" (i ndryshuar) neni 4, pika 1, neni 8, shkronjat "a" dhe "j", neni 16, ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"(i ndryshuar) neni 13, pika 2 si dhe në ligjin Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, pasi verifikuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Fier, të miratuar në mbledhjen e datës 05.06.2026, të mbajtur me procesverbalin e mbledhjes në datë 05.06.2026 me Nr 6318/5 Prot datë 09.06.2026, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 49 datë 05.06.2026 "Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile", është i shoqëruar nga relacioni Nr.6296/1 prot. datë 18.05.2026.

Prefekti, në bazë të ligjit Nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut" (i ndryshuar) neni 4, pika 1, dhe neni 8, shkronja "a", shqyrton ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Vendimi i mësipërm nuk është akt me karakter normativ pasi nuk plotëson asnjë kriter të aktit normativ por prefekti e merr në shqyrtim verifikimin e ligjshmërisë në bazë të ligjit Nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut" (i ndryshuar) neni 8, shkronja "j" ku parashikohet se "*Prefekti i Qarkut ushtron përgjegjësi dhe detyra të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore*". Verifikimi i ligjshmërisë së përdorimit të fondit të kushtëzuar i ngarkohet prefektit me VKM Nr. 414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" (i ndryshuar) pika 6.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 49 datë 05.06.2026 “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”, është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, neni 29, pika 1; Ligjin Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65, pika 3; VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3, nënpika 3.1, shkronja “a”, pika 5, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 50 datë 05.06.2026 “Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2030 në Bashkinë Fier”, është i shoqëruar nga relacioni Nr.5062/1 prot. datë 21.04.2026. Ky vendim është në përputhje me është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, neni 54, shkronja “k”; ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 28, ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar), ligji Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligji Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

PREFEKTI

Andrel Xhindi



1
2
3

3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER

Nr. 6198/1 Prot.

Fier më. 0806 .2026

VENDIM

Nr. 50 , Datë 05/06 /2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2030
NË BASHKINË FIER”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 69/2018 “Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 9936/ 2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/ 2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 9632/ 2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”, Udhëzimit të përbashkët MAS-MEKI nr. 20, datë 13.08.2025, “Për vitin shkollor 2025– 2026 në sistemin arsimor parauniversitar”, Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”, Urdhërit nr.199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së Vlerësimit të Cilësisë së kopshtit”, Ligjit Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025, Udhëzimit Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”, Udhëzimit të përbashkët MAS-MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”, Urdhërit nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”, Udhëzuesit për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit, Kryetari i Bashkisë Fier. Për sa më sipër, Këshilli Bashkak Fier,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Fier, bashkëlidhur këtij projekt vendimi.
2. Ngarkohet Qendra Ekonomike e Arsimit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT
MELSI BOGDANI**



